



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:251359
Datë: 01.11.2023
Numri i dokumentit: 04858790

C.nr. 286/23

GJYKATA THEMELORE PEJË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit MBPZHR-A.P.K të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L.S, kundër të paditurit G.G nga P rr. “.....” nr....., me bazë juridike përmbushje e kontratës, vlera e kontestit: 303.30 euro, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit kryesor me dt. 16.10.2023, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurit, dhe me dt. 01.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit MBPZHR-A.P.K.

- I. DETYROHET** i padituri G.G nga P rr. “.....” nr....., të përmbush obligimin e mbetur si në kontratë Ref. KE-1069/08 të datës 18.12.2008, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore, për ndërtimin e një kamp-shtëpizë prej drurit për qellim të rekreacionit familjar në vlerë prej 210 euro, me kamat prej 3 % në vit nga dt.13.06.2013, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- II. Refuzohet pjesërisht si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses MBPZHR-A.P.K, përtej shumës së gjykuar si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumën prej 93.30 euro, për shkak të mos përmbushjes së kontratës Ref. KE-1069/08 të datës 18.12.2008.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi kundër të paditurit me bazë juridike përmbushje e kontratës, vlera e kontestit: 303.30 euro.

I autorizuari i paditëses me padi gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë se parashtruar kundër te paditurit G.Gj, kërkojmë nga gjykata që ta obligoj te paditurin te kryej obligimet financiare 303,30 euro, i cili kishte kontratë të lidhur me ministrinë bujqësisë 1069/08, për marrjes të tokës me qira me shtëpizën prej druri në ngastrën 282, të cilit i është bërë shkëputja e kontratës për shkak të mos plotësimit të kushteve te kontratës ref: 378/13 dt. 08.05.2013, për mos kryerjen e obligimeve financiare bazuar në nenin 7 te kësaj kontrate. Sa i përket pretendimeve nga përgjigja në padi se prona nuk i është dorëzuar për shkak të pengimit nga personat e ndryshëm kjo është çështje e cila është dashur te vërtetohet nga policia organet kompetente dhe qiramarrësin asnjëherë nuk e kanë njoftuar APK se është duke u penguar nga dikush. Ndërsa sa i përket kundërshtimeve të tjera të njëjta janë të pabazuara dhe të pathemelta, mirëpo i njëjti në bazë të këtyre pretendimeve vetëm tenton ti shmanget përgjegjësisë.

I padituri me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj duke theksuar se paditësja ka dështuar në përmbushjen e kontratës duke mos i dorëzuar të paditurit paluajtshmërinë e cila ka qenë objekt i kontratës, gjithashtu i njëjti në seancën e datës 15.10.2019, i njëjti ka theksuar se ky detyrim është parashtruar pasi që ka kaluar afati i paraparë kohor për të kërkuar këtë detyrim.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: kontrata me ref: KE-1069/08 e dt. 18.12.2008 e lidhur në mes të MBPZHR-APK dhe G.Gj, pëlqimi me nr. ref: KE-1068/08 e dt. 18.12.2008, ftesa për shtyrjen e borxhit e dt. 15.01.2010, me nr. protokollin 137 i dt 18.01.2010, vendimi për shkëputje te kontratës me nr. Ref KE: 378/13 i dt. 08.05.2013, si dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqësve.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, e në lidhshmëri me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile duhet vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se paditësja dhe i padituri kishin lidhur kontratë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore me numër protokollin 3439, e datës 31.12.2008.

Kontestuese mes palëve ndërgjegjes ishte fakti i mos përmbushjes së kontratës ku pala e paditur nuk kishte bërë pagesën e qirasë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore.

Gjykata pas administrimit të provave vërtetoi se pala e paditur nuk kishte përmbushur obligimet sipas kontratës së lartcekur duke i mbetur borxh paditëses shumë prej 210. Dhe atë për vitin 2013, 2012 dhe 2011, dhe atë nga 70 euro në vit, ku kjo shumë duhet të paguhet në fillim të muajit të parë të çdo viti. Mirëpo i padituri nuk kishte përmbushur obligimet sipas kontratës me numër protokollin 3439 e datës 31.12.2008. e duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (RSFJ 1978) i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kësaj

kontrate ka paraparë se *“Kontrata quhet e lidhur kur palët kontraktuese të jenë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës”* pra, në rastin konkret palët janë pajtuar me objektin e kontratës dhe çështjen e kompensimit të qiradhënësit nga ana e qiramarrësit këtu të paditurit, ku i njëjti ka qenë i obliguar që për çdo vit të shfrytëzimit të paluajtshmërisë të paguaj shumën prej 70 euro. Mirëpo i njëjti ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra me kontratën e lartcekur, për çka duke u bazuar në nenin 262 të Ligjit Mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (RSFJ 1978) e cila parasheh *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”* për çka në rastin konkret, paditësja e ka rolin e kreditorit ndërsa i padituri e ka cilësinë e debitorit ku dhe i njëjti ka qenë i obliguar që të veproj konform pikës 6 të kësaj kontrate, për çka edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II këtij aktgjykimi duke pasur parasysh se në piken nenin 6 paragrafi 1 i kontratës është cekur se pagesa e parë për vitin 2009 bëhet në momentin e nënshkrimit të kontratës. Gjithashtu pagesa për vitin 2009 dhe 2010 është parashkruar duke pasur parasysh se i padituri me anë të përgjigjes në padi është në parashkrim dhe në bazë të nenit 360 të Ligjit Mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (RSFJ 1978) e cila parasheh *“Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes se detyrimit”* dhe paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se *“Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë”* pra meqenëse i padituri është thirrur në parashkrim gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa periodike, dhe duke u bazuar në nenin 375 Ligjit Mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (RSFJ 1978) e cila parasheh *“Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhet për tre vjet”* pra në rastin konkret padia e paditëses është parashtruar me datë 13.06.2013 dhe pala e padituri pra qiramarrësi ka qenë i obliguar që pagesat të i përmbush muajin e parë të çdo viti dhe pagesa e fundit sipas nenit 6 par 2 ka qenë viti 2013, që i bie se pagesat për vitin 2009 dhe 2010 janë të parashkruar.

Gjykata i pati parasysh edhe pretendimet tjera nga pala e paditur se paditësja nuk ka përmbushur pjesën e kontratës duke mos i dorëzuar paluajtshmërinë objekt i kontratës, mirëpo gjykata nuk i fali besimin të njëjtave pasi që sipas dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Pra, pala e paditur nuk ka bashkangjitur asnjë provë me anë të cilës do të argumentoheshin pretendimet e veta si në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit.

Gjykata lidhur me kamatën vendosi duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së (RSFJ-së 1978) duke pasur parasysh datën e parashtrimit të padisë datë 13.06.2013, kur pala paditëse i ka kërkuar kthimin e borxhit.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kreu XXVIII, Procedura në kontestet e vlerës së vogël, sqaron procedurën e kontesteve të vlerës së vogël në të cilat kërkesa nuk është më e madhe se 500 euro, dhe sipas dispozitës së nenit 491.1, 2,3 dhe 4 të LPK-së, parashihet së

aktgjykimet dhe aktvendimet me të cilat përfundon procedura në kontestet të vlerës së vogël, mund të goditën vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave me rendësi esenciale të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar së drejtës materialë të cilat shkaqe për të cilat mund të goditet vendimi gjykata është e detyruar ti theksoj dhe se afati ligjor për goditjen e këtyre vendimeve dhe për përmbushjen e tyre është 7 ditor.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që pala paditëse e ka fituar kontestin, dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe gjithashtu pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463.1 të LPK gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm.
C.nr. 286/23, datë 01.11.2023

Gj y q t a r i
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit se të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate, dhe vetëm për shkelje të dispozitave të ligjit për procedurën kontestimore dhe për shkak të aplikimit të gabuar të se drejtës materiale.